

KLSH merr pjesë në takimin e parë të Rrjetit Ndërinstitucional të Koordinatorëve “Kuvend - Institucione të pavarura” për fuqizimin e mbikëqyrjes parlamentare

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka marrë pjesë në takimin e parë teknik të Rrjetit Ndërinstitucional të Koordinatorëve “Kuvend - Institucione të pavarura”, të organizuar nga Kuvendi i Shqipërisë në bashkëpunim me Global Partners Governance (GPG) në datën 26.11.2024 në Tiranë.

Kjo nismë synon fuqizimin e mbikëqyrjes parlamentare dhe përmirësimin e bashkëpunimit me institucionet e pavarura në mënyrë të vazhdueshme dhe të qëndrueshme.

Rrjeti Ndërinstitucional i Koordinatorëve “Kuvend - Institucione të pavarura” do të përfshijë përfaqësues të përhershëm nga çdo institucion i pavarur që raporton në Kuvend, duke krijuar një strukturë të qëndrueshme komunikimi dhe koordinimi, për t’i mundësuar Kuvendit monitorim efektiv, transparencë të lartë dhe qasje të besueshme ndaj informacionit. Rrjeti do të mbledhë dhe ndaj informacionin e nevojshëm për monitorimin dhe zbatimin e rekomandimeve.



Përmes projektit “Mbështetje për Parlamentin dhe shoqërinë civile” (PACEP II), qeveria zviceriane synon të mbështesë dhe fuqizojë mbikëqyrjen parlamentare, në kuadër të procesit të integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Një nga shtyllat e projektit lidhet me fuqizimin e institucioneve të pavarura. Projekti synon të përmirësojë aftësitë e institucioneve të pavarura për të ofruar rekomandime të zbatueshme dhe të matshme përmes standardeve të reja, cilësore të raportimit dhe ngritjes së kapaciteteve të stafit.